



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
NJËSIA ADMINISTRATIVE, NJËSIA BASHKIAKE NR.9

Nr. _____ Prot

Tiranë 15.11.2017

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot në datë 15.11.2017, në sallën e mbledhjeve të Njesisë Administrative nr.9.

Morrën pjesë në këtë takim, Administratorja e Njesisë Administrative, nr.9, **Znj.Adelina ALBRAHIMI** dhe qytetarë nga Njësia Administrative Nr.9, Bashkia Tiranë.

I deleguar nga Bashkia Tiranë, **Z.Erind BEJKO**, Drejtor I Përgjithshëm I Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimit me Njësitë Administrative dhe Emergjencave Civile.

Rendi I Ditës : “Dëgjese publike për buxhetin e vitit 2018 për Njësine Administrative Nr.9,Bashkia Tiranë”

Znj.Adelina Albrahimi, Administratore e Njesisë Nr.9, mban nje fjalim përshëndetës dhe falenderues për të gjithë pjesëmarrësit dhe për punën e kryer në Njësine nr.9, gjatë vitit te fundit.Me pas fillon të relatojë mbi investimet e kryera në këtë vit në Njësine.9, konkretisht për:

- Përfundimi I segmentit të parë për zgjatimin e bulevardit “Zogu i I”
- Reabilitimi I Tregut Mine Peza
- Rikonstruksioni I Bibliotekes së Njesisë
- Rikonstruksioni I rrjetit të ujësjesit te Blloku banimit rruga “Sulejman Pasha”
- Rikonstruksion I rrjetit të ujësjesit tek rrugët “Rreli, “Demir Progri”,”Pirro Naçi”, “Ferit Sinica”, “Andrea Themeli”. “Zhak Burkar”, “Mantho Nakuçi”, Gazmend Zajmi”, “Myslym Aga Beshiri”, “Hasan Baku”.
- Ndërtimi I korsisë së biçikletave tek trotuari I mesit Bulevardi “Zogu i I”
- Rikonstruksioni I sheshit mes pallateve tek rruga “Hasan Ceka”.
- Fillimi I punimeve për ndërtimin e shkollës 9- vjeçare “Servete Maçi”.
- Rikonstruksioni I rrugës “ Josif Pashko – Uzina Dinamo”
- Rikonstruksion I rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrel” me rrugën ‘Skender Kosturi”
- Sistemim I kolektorit të ujërave të bardha ne Rrugën “Ramazan Kasa”

Z.Erind Bejko :Prezanton Projektbuxhetin e Bashkisë të vitit 2018.

Duke u ndalur më konkretisht tek Njësia Administrative Nr.9 ai tha se për vitin 2018 parashikohet të kryhen këto investime:

1.Investimet tek blloku “Zogu I Parë”.

2.Investimet tek blloku Besa-Siri Kodra .

3. Investimet tek korsitë e bicikletave.
4. Rehabilitimi I Unazës Mesme për të lehtësuar trafikun.
5. Rikualifikimi i bllokut Mine Peza-Rruga Fortuzi-Zogu I Parë-Haxhi Hysen Dalliu-Asim Vokshi.
6. Prishja e murit te Arkivit Shteterorë_për të lehtësuar kalimin ndërmjetë Rrugës “Reshit Petrela”-Rruga”Skënder Kosturi(Rruga Burgut).
7. Rikonstruksion I Rrugës “Ibrahim Ndroqi” duke ndërhyrë në fasad.
8. Ndërhyrje totale tek fasada e pallatit “Ismail Kadare” në Unazën e vogël për krijimin e harmonisë me qendrën e qytetit.
9. Rikonstruksion i kopështit nr.36 i cili është pothuaj në përfundim.

Z.Bejko Theksoi se gjitha investimet e bëra deri tani janë kryer fale mbledhjes në nivel shumë të lartë të detyrimeve të mbledhura nga bizneset në masën 90-95%

Diskutime:

Pas prezantimit të projekt-buxhetit 2018, fjalën e kërkoi Znj.Fatmira Vrapit, ndërlidhëse me komunitetin e cila ngriti shqetësimin për kanale të hapura tek Rruga Sulejman Pasha dhe Maliq Muça.

Z.Bejko theksoi se këto rrugë janë pjesë të bllokut Rruga“Mine Peza”-Rruga“Fortuzi”-Bulevardi Zogu I Parë I cili është në rikualifikim.

Me pas fjalën e kërkoi Lulezim Luli, ndërlidhës me komunitetin I cili ngriti shqetësimin për bllokun “Jordan Misja”- Rruga “Albanopoli”.Janë katër rrugica të pashtruara me asfalt.

Znj.Adelina Albrahimi sqaroi se ky bllok është në rikualifikim dhe shumë shpejt do përfundoj dhe asfaltimi i tij.

Ndërkohe qytetari Lulezim Luli duke falenderuar Bashkinë Tiranë për punën e bërë deri tani, ngriti dhe një shqetësim tjetër, shtylla e tensionit tek rruga”Isuf Balta”ndodhet në mes të rrugës duke u bërë pengesë për qarkullimin rrugorë.

Z.Bejko theksoi se kjo pjesë nuk është kompetencë e Bashkisë Tiranë.

Znj.Adelina sqaroi se është dërguar shkresë OSSHE-s nga Njësia Administrative nr.9 , për të gjitha shtyllat në mes të rrugës që ndodhen brënda territorit të njësisë dhe është marrë konfirmimi se shumë shpejtë do merren masa për heqjen e tyre.

Më pas mbledhja u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!